

RELACION

PËR

AKTIN NORMATIV “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.99/2018 “PËR BUXHETIN E VITIT 2019”, TË NDRYSHUAR”

A. MËNYRA E NDËRHJRJES

Ky akt normativ propozohet në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës. Në këtë dispozitë kushtetuese parashikohet që, Këshilli i Ministrave ka të drejtën e nxjerrjes së këtyre akteve normative me fuqinë e ligjit.

Akti normativ, gjithashtu, plotëson të gjitha kriteret e analizuara nga Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj, veçanërisht, vendimi nr.24 datë 10.11.2006, vendimi nr.23, datë 16.4.2014 etj. Konkretisht, për miratimin e një akti normativ kërkohet të plotësohen kushtet që vijojnë¹:

1. Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit;
2. Përkohshmëria e masave që përmban akti normativ me fuqinë e ligjit;
3. Fuqia ligjore e këtyre akteve dhe kufizimet për nxjerrjen e tyre;
4. Miratimi i aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Kuvendi.

1. Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit;

Neni 101 ka parashikuar “nevojën” dhe “urgjencën” si rrethana dhe situata fakti që vlerësohen rast pas rasti. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ndërmarrë procesin dhe ka përgatitur skenarin e rishikimit të buxhetit 2019. Ky rishikim propozohet t’i nënshtrohet procedurës së aktit normativ, aspekti i nevojës dhe emergjencës të të cilit lidhet me këtë arsye kryesore:

- Alokimin e fondeve të nevojshme buxhetore për mundësimin e akordimit të shpërblimit të fundvitit për kategorinë e pensionistëve, në përputhje me programin ekonomik të qeverisë dhe mbështetur në dispozitat ligjore të fushës së shpërblimeve dhe të përfitimeve të tjera sociale.

Njëkohësisht, nevoja dhe urgjenca konsiston edhe në faktin se synon:

¹ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.24, datë 10.11.2006

- a) të ruajë nivelin e planifikuar në buxhetin e vitit 2019 të parametrave kryesorë makroekonomikë të tillë si: nivelin e deficitit buxhetor (rrjedhimisht dhe nivelin e borxhit publik), ndërkohë që niveli i suficitit primar vazhdon të ruhet në terma pozitivë nominalë dhe kundrejt PBB-së.
- b) të realizojë disa rialokime të brendshme mes zërave të shpenzimeve, pa efekt shtesë në buxhet, me qëllim optimizimin e performancës së realizimit të shpenzimeve, si korente ashtu edhe kapitale.

2. Përkohshmëria

Akti normativ vepron me fuqinë e ligjit për një periudhë kohe, maksimalisht 45-ditore. Përkohshmëria e këtij akti lidhet me kushtin e domosdoshëm të shqyrtimit të tij nga Kuvendi, i cili, nëse e miraton, e kthen atë në ligj. Për këtë arsye, menjëherë pas miratimit të aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Këshilli i Ministrave, ky akt do të dërgohet për miratim në Kuvend, me qëllim fillimin e procedurave parlamentare përkatëse.

B. QËLLIMI I HARTIMIT TË KËTIJ PROJEKTAKTI

Akti normativ që ju propozojmë përcakton dhe synon, si më poshtë vijon:

- Një shpërblim financiar për kategorinë e pensionistëve, me qëllim përmirësimin e nivelit të plotësimit të nevojave të pensionistëve, nëpërmjet mbulimit të një pjese të shpenzimeve familjare për festat e fundvitit. Konkretisht,
 - Shpërblimi individual propozohet të jetë 3 000 lekë për çdo pensionist.
 - Nga shpërblimi i parashikuar do të përfitojnë 663 227 pensionistë dhe përfitues të tjerë, nga të cilët: (i) mbi 530 364 janë pensionistë në pension pleqërie; (ii) 67 754 janë në pension invaliditeti; (iii) 49 849 janë në pension familjar dhe, (iv) mbi 13 260 persona të tjerë janë në trajtim financiar me pension social, pension apo trajtim të veçantë financiar si minatorë të nëntokës, punonjës të ish-ndërmarrjeve ushtarake dhe ushtarakë në pension të parakohshëm.
 - Efektet financiare, të llogaritura në shumën 1 990 milionë lekë do të përballohen (i) nga buxheti i ISSH-së në masën 400 milionë lekë dhe (ii) nga buxheti i shtetit në zërin “shpenzime kapitale” në masën 1 590 milionë lekë, referuar projekteve të parrealizuara deri në këtë moment, për vitin 2019.
 - Instituti i Sigurimeve Shoqërore është përgjegjës për procedurat e administrimit dhe të pagimit të këtij shpërblimi. Shpërblimi kalon në llogaritë e pensionistëve në muajin dhjetor 2019 dhe paguhet po gjatë këtij muaji. Në rastet kur pagesat efektive nuk kryhen brenda muajit dhjetor 2019, ato do të paguheshin gjatë vitit të ardhshëm buxhetor 2020.

- Rialokime brenda zërave të shpenzimeve në buxhet, pa efekt shtesë buxhetor, të cilat bëjnë të mundur:
 - Shtesën prej 70 milionë lekësh për MSHMS-në, për mbulimin e shpenzimeve në zërin “Bonusi i bebeve”, si rrjedhojë e numrit të lartë të lindjeve të regjistruara, sidomos gjatë gjysmës së dytë të vitit 2019. Kjo shtesë është mbuluar përmes kursimeve në zërin e personelit.
 - Shtesën prej 300 milionë lekësh për MSHMS-në në skemën “NE & PAK”, në zbatim të ligjit të ri “Për mbrojtjen sociale”, për mbulimin e shpenzimeve të pagesës së invaliditetit për kategorinë e invalidëve që nuk përmbushin kriteret për pension invaliditeti. Kjo shtesë është mbuluar nëpërmjet pakësimit në të njëjtën masë të transfertës buxhetore të ISSH-së.
 - Shtesën prej 235 milionë lekësh për fondin rezervë të buxhetit të shtetit, i cili, aktualisht, ishte në nivelin zero për vitin 2019, me qëllim krijimin e një “buffer” deri në fund të vitit për çdo eventualitet, sidomos të lidhur me situatën pas tërmetit të datës 26.11.2019.
 - Shtesën prej rreth 12.8 milionë lekësh në zërin “Subvencioni i kredive të strehimit” për përballimin e nevojave shtesë pas tërmetit të datës 26.11.2019. Kjo shtesë është mbuluar nëpërmjet kursimeve në të njëjtën masë, në zërin e investimeve të brendshme të programit të “Strehimit”.

Në përfundim, është me rëndësi të theksohet që ndryshimet e propozuara nuk prekin treguesit kryesorë makroekonomikë dhe fiskalë, duke ruajtur deficitin në nivele të pandryshueshme e duke forcuar më tej objektivin e qeverisë për qëndrueshmëri fiskale.

KËSHILLI I MINISTRAVE